KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

ANALIZË

MBI ZBATIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.124/2024 "PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE"

SHTATOR 2026

Ky dokument ka karakter analitik dhe orientues. Ai nuk zëvendëson ligjin, vlerësimin individual të rrethanave të çdo rasti, vendimmarrjen e Komisionerit ose kontrollin gjyqësor

1. Hyrje

Miratimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “ligji nr. 124/2024”) përbën një zhvillim të rëndësishëm në forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, në veçanti të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 124/2024, Zyra e Komisionerit ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore në funksion të konkretizimit të dispozitave të ligjit dhe garantimit të zbatimit të tij në praktikë. Këto akte synojnë të përcaktojnë rregulla dhe procedura më të detajuara për kontrolluesit në sektorin publik dhe privat, duke lehtësuar përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe duke kontribuar në forcimin e standardeve për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zbatimi i akteve nënligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale është po aq i rëndësishëm sa zbatimi i vetë ligjit, pasi këto akte konkretizojnë dhe detajojnë kërkesat ligjore, duke përcaktuar rregulla, procedura dhe standarde të nevojshme për zbatimin e tyre në praktikë. Moszbatimi i këtyre akteve mund të krijojë paqartësi në interpretimin dhe përmbushjen e detyrimeve nga kontrolluesit, të sjellë praktika të ndryshme ndërmjet institucioneve dhe subjekteve private, si dhe të cenojë efektivitetin e mekanizmave, të parashikuar për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë arsye, respektimi i kuadrit të plotë rregullator, i përbërë nga ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të tij, është thelbësor për garantimin e një zbatimi të njëtrajtshëm dhe të qëndrueshëm të legjislacionit, rritjen e sigurisë juridike, forcimin e përgjegjshmërisë së kontrolluesve në sektorin publik dhe privat, si dhe sigurimin e mbrojtjes efektive të të drejtave dhe lirive themelore të individëve lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre personale.

Në këtë kuadër dhe në përmbushje të detyrimit të rekomandimeve të “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026, pika 1” duhet kryer një vlerësim i plotë për zbatimin në praktikë të akteve nënligjore të miratuara në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me qëllim evidentimin e vështirësive, boshllëqeve dhe ndikimit real në zgjidhjen e rasteve konkrete brenda tremujorit të tretë të këtij viti. Zyra e Komisionerit ka kryer një analizë me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit nga kontrolluesit e të dhënave personale në sektorin publik dhe privat të akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Analiza synon të evidentojë shkallën e njohjes dhe zbatimit të kërkesave të përcaktuara në këto akte, masat e ndërmarra nga kontrolluesit për përmbushjen e detyrimeve përkatëse, si dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të tyre në praktikë.

Nëpërmjet shqyrtimit të praktikave të ndjekura nga kontrolluesit në të dy sektorët, synohet të krijohet një pasqyrë e përgjithshme mbi nivelin e përputhshmërisë me kuadrin rregullator në fuqi, të identifikohen problematikat dhe mangësitë e

mundshme në zbatimin e tij, si dhe të përcaktohen nevojat për ndërhyrje, udhëzime apo masa mbështetëse. Gjetjet e kësaj analize do të shërbejnë si bazë për hartimin e rekomandimeve konkrete, me synim përmirësimin e zbatimit të akteve nënligjore, forcimin e përgjegjshmërisë së kontrolluesve dhe garantimin e një mbrojtjeje efektive të të dhënave personale në sektorin publik dhe privat.

2. Metodologjia

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit ka realizuar një vlerësim të nivelit të zbatimit të akteve nënligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, të miratuara në zbatim të ligjit nr. 124/2024. Analiza evidentoi nivelin e zbatimit të akteve nënligjore, vështirësitë e hasura nga kontrolluesit dhe ndikimin e tyre në garantimin e përputhshmërisë me ligjin nr. 124/2024. Ajo është hartuar mbi bazën e rezultateve të hetimeve administrative, rekomandimeve dhe vendimeve të marra nga Zyra e Komisionerit gjatë periudhës raportuese. Gjetjet evidentojnë se niveli i zbatimit të akteve nënligjore është i ndryshëm sipas natyrës së detyrimeve të parashikuara.

Për këtë qëllim, janë analizuar rezultatet e 67 hetimeve administrative të zhvilluara nga Zyra e Komisionerit. Prej tyre, 22 hetime janë iniciuar në vijim të ankesave të paraqitura nga qytetarët, ndërsa 45 hetime janë ndërmarrë me iniciativë të Zyrës së Komisionerit (*ex officio*), në ushtrim të kompetencave të saj mbikëqyrëse.

Sektorët kryesorë në të cilët janë realizuar hetimet administrative janë: sektori i ndërtimit, sektori i farmacive dhe depove farmaceutike, sektori arsimor (universitete - verifikim rekomandimi), sektori i shërbimeve TIK dhe telekomunikacionit.

Në kuadër të hetimeve pranë autoriteteve kompetente dhe strukturave të tjera publike, janë realizuar në organizata jofitimprurëse (OJF): 2 hetime administrative, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve - 1 hetim administrativ, Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale - 2 hetime administrative, Qendra Spitalore e Burgjeve - 1 hetim administrativ, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe 4 drejtori vendore - 5 hetime administrative. Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes me Eurojust-in, kanë qenë në fazë hetimi administrativ prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, Fier, Shkodër, Vlorë, Kukës dhe Durrës.

3. Shtrirja territoriale

Hetimet administrative janë zhvilluar kryesisht në qytetin e Tiranës, si dhe në disa rrethe të tjera të vendit, përshirë Durrësin, Vlorën, Shkodrën etj., duke siguruar kështu një shtrirje territoriale të gjerë të veprimtarisë mbikëqyrëse. Ky numër përbën bazën e informacionit për evidentimin e problematikave sistematike dhe të përsëritura.

4. Vendimmarrja

Komisioneri për këtë periudhë është shprehur me: 27 Rekomandime, 12 Vendime, që korrespondojnë me 20 sanksione administrative, si dhe 1 Urdhër për korrigjimin e të dhënave personale të subjektit të të dhënave në kontrollues publik. Vendimmarrjet me sanksion administrativ gjobë janë përllogaritur mbi një instrument të ri "Metodologjia për përllogaritjen e masës së sanksioneve", miratuar me Udhëzimin nr. 6/2025, e cila synon vlerësimin e drejtë, transparent dhe korrekt të masës së sanksionit administrativ ndaj një kontrolluesi/përpunuesi shkelës të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka ushtruar në mënyrë aktive rolin e saj këshillimor dhe monitorues përmes dhënies së 57 mendimeve dhe opinioneve ligjore mbi akte rregullatore, që përfshinin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përpunimin e të dhënave personale. Në total, janë shqyrtuar 25 projektakte, ndërsa janë dhënë 32 opinione ligjore mbi nisma të ndryshme të kontrolluesve publikë dhe privatë. Nëpërmjet këtyre mendimeve është synuar garantimi i përputhshmërisë së akteve me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Rezultatet e analizës

Analiza evidentoi nivelin e zbatimit të akteve nënligjore, vështirësitë e hasura nga kontrolluesit dhe ndikimin e tyre në garantimin e përputhshmërisë me ligjin nr. 124/2024.

- Gjetjet evidentojnë se niveli i zbatimit të akteve nënligjore është i ndryshëm sipas natyrës së detyrimeve të parashikuara. Ndërsa aktet që lidhen me detyrimet formale paraqesin një nivel më të lartë zbatimi, mangësitë më të theksuara evidentohen në implementimin e masave teknike dhe organizative, dokumentimin e proceseve të përpunimit, formalizimin e marrëdhënieve kontrollues - përpunues dhe ngritjen e Sistemeve të Menaxhimit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (PIMS). Këto gjetje do të shërbejnë si bazë për orientimin e veprimtarisë mbikëqyrëse, hartimin e materialeve udhëzuese dhe përmirësimin e mëtejshëm të praktikave të kontrolluesve.

- Gjithashtu, analiza identifikoi disa problematika të përbashkëta në zbatimin e ligjit nr.124/2024 dhe akteve nënligjore, të cilat lidhen me:
  - ✓ mosharmonizimin e rregulloreve të brendshme me kërkesat e legjislacionit të ri;
  - ✓ mungesën e politikave për ruajtjen, anonimizimin dhe asgjësimin e të dhënave personale;
  - ✓ nivelin e ulët të dokumentimit të proceseve të përpunimit dhe regjistrave përkatës;
  - ✓ mosdokumentimin e masave teknike dhe organizative të sigurisë;

- ✓ mungesën e procedurave për përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale;
- ✓ mangësi në administrimin e sistemeve të video-survejimit (CCTV);
- ✓ mosformalizimin e marrëdhënieve me përpunuesit sipas kërkesave ligjore;
- ✓ moscaktimin ose mosfunksionimin efektiv të rolit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO), përfshirë mungesën e trajnimeve dhe të dokumentimit të veprimtarisë së tij.

- Rezultatet e analizës tregojnë se sfidat kryesore në zbatimin e ligjit nr. 124/2024 tashmë nuk lidhen më me mungesën e kuadrit normativ, por me implementimin efektiv të tij. Shumica e problematikave të konstatuara janë të natyrës organizative, procedurale dhe dokumentuese, çka tregon se kontrolluesit ende nuk kanë ndërtuar sisteme të plota të përputhshmërisë sipas modelit të kërkuar nga ligji nr. 124/2024 dhe aktet nënligjore të Komisionerit.

- Përsëritja e të njëjtave gjetje në institucione me profile të ndryshme tregon se nevojitet një qasje më e unifikuar për zbatimin e akteve nënligjore, e shoqëruar me udhëzime praktike, monitorim sistematik dhe programe të vazhdueshme trajnimi nga ana e kontrolluesve. Në këtë kuadër, rekomandimet e Zyrës së Komisionerit kanë shërbyer jo vetëm për adresimin e mangësive individuale të kontrolluesve të hetuar, por edhe si standarde referuese për forcimin e kulturës së përputhshmërisë në të gjithë sektorin publik dhe privat.

- Pavarësisht reagimit të kontrolluesve ndaj rekomandimeve të lëna, Zyra e Komisionerit në proceset e verifikimit të rekomandimeve do të identifikojë më hollësisht nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna sipas afateve të përcaktuara.

- Zyra e Komisionerit konstatoi mangësi në organizimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto problematika theksojnë mungesën e një kulture të konsoliduar të llogaridhënies, të menaxhimit të riskut dhe të sigurisë së informacionit.

Në mënyrë të detajuar, u konstatuan këto gjetje:

- ➢ Mungesë e dokumentimit të aktiviteteve të përpunimit dhe e përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë politikat e sigurisë, masat teknike dhe organizative dhe rastet e profilizimit.
- ➢ Aktet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale mungojnë ose nuk janë të përshtatura me veprimtarinë reale të institucionit. Në shumë raste ato nuk përcaktojnë kategoritë e të dhënave që përpunohen, qëllimet e përpunimit, të drejtat e subjekteve të të dhënave, nivelet e aksesit, masat e

sigurisë, afatet e ruajtjes dhe procedurat e asgjësimit, ose nuk janë përditësuar në përputhje me ligjin nr. 124/2024.

- Mungesë e një strategjie ose plani për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (PIMS).
- Mungesë e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe sigurisë së të dhënave personale.
- Mungesë e procedurave të posaçme për përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale (penale, biometrike, gjenetike dhe shëndetësore), përfshirë administrimin, nivelet e aksesit, transferimin dhe masat e sigurisë.
- Mungesë e dokumentimit dhe rregullimit të sistemeve elektronike të përpunimit, duke mos përcaktuar administrimin e sistemeve, përgjegjësitë e përdoruesve, nivelet e aksesit dhe masat e sigurisë.
- Mosrespektim i parimit të kufizimit të ruajtjes së të dhënave, për shkak të mungesës ose moszbatimit të afateve të ruajtjes dhe procedurave të asgjësimit ose anonimizimit të tyre.
- Kontratat me përpunuesit nuk përmbajnë detyrimet e kërkuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nuk përcaktojnë qartë përgjegjësitë e palëve.
- Mungesë e caktimit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO) dhe e trajnimit të punonjësve që përpunojnë të dhëna personale.

6. Aktet nënligjore të cilat paraqesin problematika për t'u evidentuar janë:

Udhëzimi nr. 03, datë 30.04.2025 "Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejimit" – mangësitë lidhen kryesisht me mungesën e tabelave informuese, mungesën e akteve të brendshme rregullatore, mungesën e përcaktimit të qartë të qëllimit të video-survejimit, moskryerjen e analizës së nevojshmërisë dhe proporcionalitetit, monitorimin e hapësirave përtej atyre të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të video-survejimit dhe përpunimit, ruajtjen e pamjeve filmike përtej afateve të lejuara dhe kontrollin e pamjaftueshëm të aksesit dhe gjurmueshmërisë.

Udhëzimi nr. 08, datë 20.11.2025 "Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues" – nxori në pah mangësi në dokumentimin e bazave ligjore, qëllimeve të përpunimit, si dhe mungesën e dokumentimit të procedurave të vlerësimit dhe vendimmarrjes për certifikim. Vlen të theksohet se ky akt nënligjor u drejtohet organizmave certifikues dhe procesit të akredimit të tyre, nuk është një listë detyrimesh të përgjithshme për çdo kontrollues të të dhënave personale (13 kontrollues).

Udhëzimi nr. 09, datë 20.11.2025 "Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të

dhënave personale” (23 kontrollues) – rezulton të jetë një nga aktet me numrin më të lartë të problematikave të evidentuara dhe akti me nivelin më të ulët të zbatimit. Në shumicën e rasteve të analizuara u konstatua mungesa e një sistemi të strukturuar për menaxhimin e të dhënave personale funksional, mungesa e auditimeve të brendshme periodike dhe mungesa e analizës së riskut, e politikave dhe procedurave të dokumentuara të sigurisë, e procedurave për menaxhimin e incidenteve, mungesa e administrimit të Regjistrit të Veprimtarive të Përpunimit (ROPA), si dhe mungesa e implementimit, dokumentimit dhe rishikimit të masave teknike dhe organizative, që garantojnë një nivel të përshtatshëm për rrezikun.

Udhëzimi nr. 06/2025 “Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e masës së sanksioneve administrative” – është miratuar në zbatim të ligjit nr. 124/2024. Ky udhëzim është hartuar bazuar në Udhëzuesin nr. 04/2022 të EDPB-së, që lidhet drejtpërdrejt me nenin 83 të GDPR-së. Udhëzimi nr. 06 përcakton metodologjinë për përllogaritjen e sanksioneve administrative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Një nga sfidat kryesore në zbatimin e tij lidhet me interpretimin dhe zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj metodologjie nga kontrolluesit dhe gjykatat, të cilët rrezikojnë të përqendrohen te shuma përfundimtare e gjobës, pa analizuar kriteret dhe hapat që kanë çuar në përcaktimin e saj. Kjo problematikë bëhet veçanërisht e dukshme në proceset gjyqësore kundër vendimeve të Komisionerit, ku interpretimi i gabuar i metodologjisë mund të çojë në vlerësime të ndryshme për raste të ngjashme, si dhe vështirësi në krijimin e një praktike gjyqësore të qëndrueshme dhe të parashikueshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Një qasje e tillë mund të krijojë pasiguri juridike si për kontrolluesit, ashtu edhe për subjektet e të dhënave personale, mund të çojë në cenimin e diskrecionit ligjor të organit mbikëqyrës (Zyra e Komisionerit) dhe në keqinterpretimin e parimit të proporcionalitetit gjatë caktimit të sanksioneve.

Ndryshimet e vërejtura në praktikën gjyqësore së fundmi rrezikojnë të cenojnë qëndrueshmërinë dhe parashikueshmërinë e vendimmarrjes, duke krijuar pasiguri juridike. Për këtë arsye, zbatimi i drejtë, i njëtrajtshëm dhe proporcional i metodologjisë është thelbësor për efektivitetin e ligjit nr. 124/2024 dhe për ruajtjen e efektit parandalues dhe korrigjues të sanksioneve administrative.

Rruga “Abdi Toptani”, Nr.5,
kodi postar 1001, Tiranë

+355 42 23 7200

Nr. i Gjelbër: 08002050

info@idp.al

www.idp.al